



Prishtinë 22 mars 2013
Kodi i ZRRE: V_516_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit) dhe,
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE7) me dokumentacionin relevant sqarues;

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 22 mars 2013 nxori këtë:**

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)** që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për Furnizuesin Publik me energji elektrike për një periudhë rregullative 4 vjeçare duke filluar nga 1 prilli 2013 deri më 31 mars 2016.

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin e KEK-Gjenerimit, për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes ngarkesave për energji dhe kapacitet.
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij që MAR të rimerret nga Gjeneratorët e Rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut i lëshuar me datën 18 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut i publikuar me datën 8 janar 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë i publikuar me datën 22 shkurt 2013.



- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Gjeneratorët e Rregulluar për periudhë rregullative 4 vjeçare duke filluar nga 1 prilli 2013 deri më 31 mars 2016 të paraqitura në tabelën në vijim.

Vlerësimi përfundimtar i MAR-it për KEK Gjenerimin	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej € 000's
"TC Kosova A" dhe "TC Kosova B"	150,957	151,584	152,776	152,697	608,014

- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Gjeneratorët Rregulluar të paraqitura në tabelë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore dhe zbatimit të Faktorit Profilizues, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit.
- IV. Të Licencuarit për Gjeneratorët e Rregulluar duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për kapacitet dhe energji për mbulimin e Të hyrave të Lejuara Maksimale të përcaktuara me këtë Vendim, brenda një afati sa me të shkurt.
- V. Ngarkesat e propozuara nga të licencuarit duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullin për Çmimet e Gjenerimit.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhës shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtar

Krenar Bujupi, Anëtar